

## Mbi Arin

Ayra - fr. or (ari)

Rrënja ar në kuptimin e arit si dhe atë të dritës, të diellit, të parimit supreme, gjendet edhe në shumë fjalë të përbëra në sanskritisht.

Jungu citon shpjegimin e këndshëm të alkimistit Michael Maier në “De Circulo Physico Quadrato”, sipas të cilit dielli, ndërmjet miliona e miliona udhëtimeve të tij rreth tokës (ose anasjelltas), ka thurur fije të arta rreth e rrotull saj. Ari është shëmbëlltë e dritës së diellit dhe pra që këtej, e inteligjencës hyjnore. Ndërsa zemra është shëmbëlltë e diellit tek njëriu, këtë rol në Tokë e lot ari.

arya - m. burrë i një shtrese të lartë  
kurse në shqipen e arbëreshve:

ar-i - i fejuar, dhëndër; hero, luftëtar, burrë i fortë  
jar, ajr, arth - dhëndër, burrë,  
ndërsa në Malësi të Madhe: aruj - burrë, mashkull.

Kështu kuptohet përse në shprehjen (mallkimin): “...në kjo fsh aruj t’u thaftë vetja, në kjo fsh lashujë të shterrshin gjinat!...” ku aruj rri, sic thamë, për mashkull, kurse lashujë, për femër.

Identifikimi i rrënjës gjermanishte heim me shqipen hyn (folja hyj, hyn, hyra, himun etj.) përligjet duke analizuar edhe një sërë fjalësh të tjera gjermanisht, që e përmbajnë këtë rrënjë.

Heim - shtëpi, hymje, e hyrë  
geheim - i hymtë, i futur, i fshehtë (ke hym - ke hy jam)  
Geheimnis - futje, fshehje, sekret  
që zbërthehet si : Ke himun ash(t)

Dhe akoma në gjermanisht:

Gehirn - tru (arab a-kalla)

dhe në shqip për një njeri që cmendet, që i dalin trutë, thuhet edhe: çkalloi domethënë: i doli (‘ç) e kallmja, e pra që ka hyrun, ajo që a kallë.

Haimat = at-dhe

Zbërthimi i kësaj fjale të rëndësishme gjermane na jep:

Heim + at

e pra me shqipen hymje (e) Atit, domethënë shtëpia e Zotit. Paralelizmi me hebraishten Beth - El (Shtëpia e Zotit, e Yllit), është i plotë. Vëmë në dukje se edhe kjo fjalë hebraisht gjen motivimin e saktë ndërjet shqipes

Beth - sh, bat, byth, botë, botore, bator (faktor)

Në gjuhën Mongole: Ulan Bator (Bati i Yllit, Guri i Yllit, shtëpia e Yllit)

Në rusisht gorod, qytet, nga fjala shqip, gur; ashtu dhe sllavishtja grad (qytet), lidhet gjithë po me rrënjën shqipe gur. Ashtu dhe, më në fund, fjala Arbana, duke marrë parasysh se bana në shqip do të thotë bane-së (tek Arbëreshët: banë-a = it. sede, dimora, abitacolo), jep në zbërthim:

Ar + bana

Pra bana (e) Ar-it, Ar-i është parimi suprem, sikundër El-i (Ylli), sikundër At-i. Fjala shqip Arbëni do të thotë pikërisht Banesa e Arit dhe asgjë tjetër.

E vërteton zbërthimin e fjalës Arbëni, ashtu sikundër që e bëmë ne. Edhe fjalët latinisht: urbanus (urban); urbis (qytet) etj, atje dalin. Tek trajta ur e latinishtes kemi reflektimin e ar te shqipes në ur.

Për sa i përket operatorit At, në shumë gjuhë të lashta ai ka treguar parimin suprem.

Ne pamë nga teksti mbi simbolizmin e arit në popujt e lashtë se ar-i, ka simbolizuar tek ata popuj, Parimin Suprem, por edhe atë Zanafillor, e pra dhe atë më Absolutin, më Superlativin, më të mirin, më të nderuarin, më të lashtin e më të mbramin etj. E tërë kjo simbolikë është konkretizuar në gjuhë. Por në disa sisteme gjuhësore trajta ar është reflektuar edhe në Ur, në Er, në Or, në Ir.

(Ar) = (Ur) = (Er) = (Or) = (Ir) ..... = O

Ekuivalentizmi i këtij operatori me ideogramën (simbolin) O përligjet në këtë mënyrë:

Në sanskritisht:

ari - rrotë, disk, e pra simboli O

ajruna - i bardhë, ngjyrë e bardhë - pra ideograma O

area - vend bosh, pra ideograma O

Në latinisht :

orbita ( or + b + ia)

dhe në shqipen ar ba ash(t) = rreth, e pra ideograma O.

Përsëri në latinisht:

Orbita - gjurmë e rrotës, trajektore, rrethore, orbitë, pra ideograma O

jep në zbërthim or+bita, dhe në shqipen: ar bëtë. ku bëtë është pjesore e lashtë e foljes shqipe bëj

\* e kështu me rradhë.

zanore + R dhe zanore + L janë nga pikpamja semantike, e njëjta gjë.

Në shqip kemi:

anglisht: star = yll (st + ar) = asht ar

shqip: istër = yll (ist + ër) = isht ar

italisht: stella = yll ( st + ella ) = asht yll.

greqisht: astir = yll. (ast + ir) = asht ar

Vëmë re se si në greqisht ka ndodhur reflektimi ar : ir

Ashtu edhe emri i përveçëm greqisht Aristotelos zbërthehet si:

ar + isht + ... + el + es

dhe ndërmjet shqipes

Ar + është(ë) + yll + ësh(t)

Pra është yll (i) artë, domethënë del po atje si edhe emri Ariel (lt. Aurel) në fleksionimin ar: aur) që zbërthehet në:

al ari = domethënë yll i artë. Vëmë re se mbares - el (il, al, el) në fund të fjalëve substantivëve, lot rolin enjë nyje dhe kjo është nyja il, që përdor italishtja (lat. ille) përpara emrave mashkullorë dhe nyja el që përdoret spanjishtja dhe arabishtja, nyje këto që lidhen me fjalën shqip yll. Nga ana tjetër, shohim: Diell - djalë, Sun - son, Sonne - Sohn. Filozofët e lashtë presokratikë të Greqisë e quanin arsyen që drejtonte botën, arke, fjalë që duhet zbërthyer, pas atyre që thamë në, ar+ke, domethënë ke "ar". Kuptojmë gjithashtu edhe që në fjalët arsye, arsim etj, theksi kuptimbartës bije tek operatori ar.

Në sanskritisht:

artha - m (qëllimi, shkak, arsye, kuptim, organ mashkullor)

Në shqipen e Malësisë së madhe, hardha ose dhe ardha = arsye, si bie fjala në shprehjen: njeri i ardhshëm, njeri i ardhshëm në kuvend. Dhe gjithashtu në shqipe:

herdhe - testikuj

që nga nxirret edhe përfundimi se fjala ardha e sanskritishes (arsye dhe organ mashkullor) dhe fjala ardha (herdhe) janë e njëjta fjalë. Tek arbëreshët ndodhet siç pamë (ar, jar = it. fidanzato, sposo, eroe, uomo forte) Jar, ajr, arth = dhëndër, burrë. Kështu që fjala arthi e shqipes, dhe fjala sanskritisht artha janë përsëri e njëjta fjalë.

Pra shohim se kuptimi i arsyes lidhet me atë të arit, e pra me parimin e dritës, të diellit. Dhe me qënë se dielli lidhet me mashkullin (simas mentalitetit primitiv; ndërsa femra lidhet me hënën), kuptohet përse në sanskritisht, p.sh

artha - arsye; mashkull

Në shqip gjithashtu : i urtë, i Urti, urtësi, rri urtë!(rri mirë!), është e qartë se i urtë dhe i artë janë nga pikpamja e bërthamës simentike, e njëjta gjë.

Në shqip ba ar ba ka domethënë ka ba: ba ar: dhe pamë se ar qëndron për or -igjinë për Ur-zeit, për të parën (në kohë). Edhe shqipja i parë mund të jetë ba ar.

Kjo lidhet me vazhdën e miteve mbi epokën e parë, të artë, të njerëzimit.: (frengjisht - Dictionnaire de mythologie ancienne et moderne - faq. 939 = Mignet)

Or ose Our = Zjarr i kulluar dhe parimi zanafillor i qenieve, dritë e pakrijuar, shkëlqim i përjetshëm: ky ishte emri dhe shëmbëlltyra pas të cilës përfytyrohej Perëndija supreme, At dhe Zot i të gjitha qënieve

Ar (Epoka e Arit) = Një kohë fatlume në të cilën mbretëronte pafajësia dhe drejtësia, ku asnjëherë vuajtja e helamtisur nga brengat gërryese nuk e përfshinte ajrin që njerëzit thithnin!.....Por që së shpejti kjo kohë e shkurtër pafajësie e lumturie të parrëfyeshme u zëvendësua nga epoka e hekurit.

Harmoni, hareshëm, hershëm, artë (hartë), i arsyeshëm, i hirshëm - lidhen të gjitha me bërthamën ar(har).

Me qënë para se ari është vështruar edhe si një element i fshehtë, i hyrë, arëherë del qartë se fjala sanskritishte hiranya, lidhet me shqipen i hyrë (i himun, i hymyn, i hyrtë), domethënë me pjesoren e foljes shqip hyj.

I pari, ari, harmonia, i hershëm, i hareshëm, hyrje, hymun, hymne, hiri, herët, hierore etj. Të gjitha këto fjalë motivohen me spektrin e një bërthame semantike të vetme, me operatorin e lirë shqip:

H (-i, -y, -yj, -imun, -yr.....etj.)

Kozmologjia - Ideja themelore e pjesës më të madhe të kosmogonive është "sakrifica kozmike", që shpreh idenë se krijimi i formave dhe i lëndës mund të realizohet vetëm me një modifikim të energjisë primordiale. Një modifikim i fillë vështrohej nga popujt më primitivë dhe protohistorikë në një trajtë të dhimshme, si një gjymtim, si një luftë ose si një sakrificë (flijim).

Kështu teksti na thotë se Purusha (sipas Rigdevës) - u bë kurban, fjalë që ndoshta mund të z'bërthehet në shqip si:

ka hyr ban, ka ban hyr - e pra kështu Purusha u bë i Hyri, Hyu.  
Kështu pra, sipas mentalitetit primitiv, Zoti vështrohet si i hyrë (kurban: ka bër hin) si i himun.  
dhe me qënëse Hyu është vështruar si qenie e hershme që ka hyrë, që është bërë kurban (ka hyr ban), që është flijuar, sakrifikuar për krijimin e botës

Are!

është shqipja ore! Po në shqip ka ekzistuar edhe një trajtë are!, Ndofta lidhet me fjalën ar, ar-i. Pra are! do të thotë, pak a shumë, o njeri!

a-nr - asnjëri.

ku a sipas privative është shqipja as .  
Lidhur me nr(njeri), duhet thënë se në shqip ekziston edhe trajta niri. Një analizë do të vinte në pah se trajta niri është e prejardhur nga një ni-ni me anë të rotacizmit së n në r, siç ndodh rëndom në shqip. Kështu n **shqip thuhet edhe nje-ni**, edhe njeri, edhe gjini edhe gjiri.

Fjala nir është shqipja njeri, në kuptimin e shifrës nji (nji) . Për të kuptuar se si njishi ka kuptimin e negativitetit (shq. ni = nji; nuk = "-") domethënë të shenjës "—", duhet të kemi parasysh se në Orient parimi negativ është vështruar si ai krijuesi, si esencë (esenca si negativiteti i kulluar, mohimi dialektik). Kjo del në pah edhe në rastin e fjalës shqip:

Hek = 1

dhe, në të njëjtën kohë, pa, zbres, heqje, e pra simboli "—" . Gjithashtu në shqip:

nis-ja dhe nus-ja

Pra dhe këtu kemi identifikimin e njisisë (nisisë) me parimin femëror, domethënë, shenjën "—" (edhe vetë fjala minus (—) lidhet me greqishten muni (organi femëror; vulva) dhe me anglishten moon (hëna, siç e dimë përfaqëson parimin femëror), ndërsa shenja plus (+), me fjalën phalus, organin mashkullor.

Në gjuhën kineze jin është parimi femëror (edhe dhe jing) dhe njëhohësisht njësia e cila tregohet atje me shenjëm \_\_\_ (ndërsa dyshit në gjuhën kineze i thonë er dhe është ar-i, parimi mashkullor që tregohet atje me === )

Kështu pra, sipas mentalitetit primitiv (Orienti), nisja e botës ka filluar me një mohim, e pra me një negativitet, e pra me simbolin "—" , e pra me parimin femëror. Ky mohim primordial është vështruar nga të lashtët si një rënie, siç do të kemi rastin të bindemi më poshtë, prandaj dhe në shqip:

"—" = hek, zbritje

Vemë në dukje së fundi se tek fjala nji ose ni, tërë pesha semantika bie tek një gërmë e vetme, tek germa n-.

Kështu sanskritishtja nis zërthehet si n+is, d.m.th, ash(t) n.

Në gjermanisht gjithashtu nein zërthehet në n+ein = nuk një.

Dhe si sanskritishtja, ashtu edhe gjermanishtja, shprehin këtu të njëjtën gjë, dhe pikërisht situatën që paraqitet nga ideograma -O, domethënë mohimin primordial (sakrificën e parë), që dha mundësi, sipas mentalitetit primitiv, për krijimin e botës.

Fakti që njëshi është marrë si njësi negative dhe është lidhur me parimin femëror (me gruan dhe me gurin - guri si Magna Matter) ka të bëjë me faktin se siç pamë edhe në citatin e sipërpërmendur nga libri i Cirlot, popuj të ndryshëm kanë menduar në mënyra të ndryshme se qenia e parë që është sakrifikuar ka qënë një grua (Tiamat në Babyloni), ose se ka qënë një burrë (Purusha në Hindi). Që këtej dhe popujt janë ndarë në hënorë (lunarë), parimi i parë ai femërori, dhe diellorë, parimi i parë ai mashkullori.

Lidhur me atë që thamë më sipër, se fjala njeri dhe fjala njëri (matëse) në shqip janë semantikisht identike, një ripohim tjetër e gjejmë në latinishte ku:

homo = njeri  
homo-genus = një-gjini  
homo-logia = një-log = një vend.

Pra, edhe latinishtja pozon në mënyrë implicite ambiguitetin

homo = njeri, njeri, 1.